

VENDIM
Nr. 85, datë 7.2.2012

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË MARRËVESHJES SË THEMELIMIT TË BANKËS
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7525, datë 3.12.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim” dhe të nenit 2 të ligjit nr. 10 429, datë 9.6.2011 “Për ratifikimin e vendimeve të Bordit të Guvernatorëve të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), rezoluta nr. 126 “Rritja e kapitalit themeltar të autorizuar, emetimi i aksioneve të paguara dhe pagesa nëpërmjet rialokimit të të ardhurave neto”, (shtojca A) dhe rezoluta nr. 128 “Shtimi i kapitalit themeltar të autorizuar, emetimi dhe nënshkrimi i kapitalit të shlyeshëm nëse kërkohet dhe shlyerja”, (shtojca B), si dhe dokumenti “Informacion për hapat që duhet të merren pas mbledhjes vjetore të vitit 2010””, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimeve të marrëveshjes së themelimit të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha